



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:020535  
Datë: 26.12.2024  
Numri i dokumentit: 06657097

P.nr. 49/24

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerinda Laiq, në çështjen penale kundër të pandehurit E.M, nga fshati ....., i Komunës së Istogut, për shkak të veprës penale “Vjedhja” nga neni 313 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën PP/II.nr.2599/2023 të datës 18.01.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 17.12.2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit E.M, si dhe mbrojtëses së tij av. Diana Bacoviq, nga Peja, e caktuar sipas detyrës zyrtare, me datën 20.12.2024, mori dhe shpalli, ndërsa me datën 26.12.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

**I pandehuri:**

E.M, i lindur me datë ..... në fshatin ....., Istog, nga babai R. dhe nëna N., e gjinisë ....., me vendbanim ....., në Pejë, jeton në një shtëpi me qira, në Komunën e Pejës, i martuar, me profesion ....., ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon numër tel. ...., i identifikuar në bazë të numrit personal të letërnjoftimit ....., i nacionalitetit ....., Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me datë 03.11.2023, rreth orës 10:20, në stacionin e autobusëve në Pejë, pikërisht në autobusin të cilin e drejton i dëmtuari R.S, i punësuar si vozitës në relacionin Mitrovicë-Pejë për firmën “.....”, i pandehuri më qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, tjetrit i’a merr pasurinë dhe atë të dëmtuarit R., në atë mënyrë që duke e shfrytëzuar momentin e volitshëm deri sa i dëmtuari shkon për të paguar peronin dhe nuk ishte askush në autobus, i pandehuri pikërisht në derën të autobusit nga ana e shoferit e merr një telefon të markës ..... ngjyrë e zezë me numër telefoni ..... në vlerë prej ..... euro pronë e të dëmtuarit R.

- Me këtë ka kryer veprën penale “Vjedhja” nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata të pandehurit në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 42, 69, 70, nenit 313 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe nenit 242, 364, 365, 449, 452, 458, 459, 460, 462 të KPPRK-së, fillimisht:

## **E GJYKON**

- I.** Me **DËNIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri gjatë periudhës së verifikimit prej dy (2) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.
- II.** Si dhe me **DËNIM ME GJOBË**, në shumen prej pesëqind (500) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III.** Nëse i pandehuri gjatë periudhës së verifikimit kryen vepër tjetër penale, dënimi i kushtëzuar nga pika I të këtij dispozitivi do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- IV.** Nëse i pandehuri dënimin e shqiptuar në të holla dështon, refuzon apo nuk mund të paguajë dënimin me gjobë të përcaktuar si në pikën I të këtij dispozitivi të aktgjykimit, gjykata në bazë të nenit 43 par. 3, të KPRK-së, do t'a zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20) euro gjobë.
- V.** Obligohet të i pandehuri që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej nga tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej nga njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- VI.** I dëmtuari R.S, me vendbanim në rr. “.....”, në Komunën e Mitrovicës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e udhëzon në kontest të rregullt civil.

## **Arsyetim**

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me 18.01.2024, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II.nr. 2599/2023, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti i ka kryer veprën penale “Vjedhja” nga neni 313 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata me datë 17.12.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, e konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i shtetit Ermal Demhasaj, i pandehuri E.M, si dhe mbrojtësjja e tij av. Diana Bacoviq nga Peja, e caktuar sipas detyrës zyrtare ndërkaq ka munguar i dëmtuari R.S i cili për mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt.

Në këtë seancë, pasi që gjykata të pandehurit i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në procedurën penale sipas KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar së i ka kuptuar këto të drejta ndërsa për mbrojtëse është pajtuar që ta përfaqësoj av. Diana Bacoviq, nga Peja, e caktuar sipas detyrës zyrtare.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, gjykata, është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë. Mirëpo paraprakisht, gjykata ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe i pandehuri E.M, ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranon fajësinë, për veprën penale që i vihen në barrë, respektivisht për veprën penale “Vjedhja” nga neni 313 paragrafi 1 të KPPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Prokurori i Shtetit, ka deklaruar së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit E.M, është pajtuar edhe mbrojtësja e tij, av. Diana Bacoviq, e cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, së një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, së pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti i Oficerit G.Sh. PK 11885 me nr. 2023-DA-1846 i dt. 04.11.2023; Raporti i policit hetues S. H. #2746 me nr. 2023-DA-1846 i dt. 04.11.2023; Deklarata e të dëmtuarit R.S e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt. 04.11.2023; Deklarata e të pandehurit E.M e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt. 14.12.2023;*

Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese deklaroi se: *në kuptim të rrethanave lehtësuese pranimin e fajësisë ndërkaq si rrethanë rënduese ndonje dënim eventual të mëparshëm.*

Mbrojtësja e të pandehurit E.M, av. Diana Bacoviq, ka deklaruar se: *si rrethanë lehtësuese i propozoj gjykatës të marr parasysh pranimin e fajësisë, dhe kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, si dhe faktin se i njëjti është penduar për veprën e kryer.*

I pandehuri E.M, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale që kam kryer, i kam kërkuar falje të dëmtuarit, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale.*

Prandaj, me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Vjedhja*” nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale t’u kryejë në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv I të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer penale dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjyqtarja e vetme gjykuese në aplikim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese mori faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë që në shqyrtimin fillestar, pendimin dhe keqardhje e shprehur për veprën e kryer penale, premtimin e tij se nuk do të kryej vepra penale në të ardhmen, ndërkaq si rrethanë rënduese gjykata ka marrë parasysh dënimet e tij të mëparshme penale dhe posaçërisht faktin se i njëjti është dënuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë- Dega në Istog - Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë P.nr.11/22, të dt.26.06.2023, i cili është bërë i plotfuqishëm me dt.24.08.2023, për shkak të veprës penale “*Vjedhja*” nga neni 313 par.1 të KPRK-së, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) muajsh dhe dënim më gjorbë në shumën prej pesëqind (500) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, po ashtu i njëjti është dënuar edhe sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog – Departamenti i Përgjithshëm – P.nr.305/20, të dt.10.12.2020, i cili është bërë i plotfuqishëm me dt.18.05.2021, për shkak të veprës penale “*Arratisja e personit të privuar nga liria*” nga neni 397 par.1 të KPRK-së, me dënim me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) muajsh i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Andaj, gjykata në bazë të rrethanave të lartë-theksuara, të akuzuarit i shqiptoi dënimin sikurse u theksua në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ardhur në përfundim se edhe me këtë dënim të shqiptuar, do të arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahet nga këto veprime/kryerja e veprës-veprave penale të këtilla.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të

akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Dënueshmeria e veprës penale “Vjedhja” nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së, me të cilën ngarkohet i pandehuri, përcaktohet me dënim me gjobë dhe me burgim deri në 3 vite, “Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”, andaj gjykata me rastin e vendosjes ka zbatuar dispozitën e nenit 43 par.1 të KPRK-së “Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) Euro evropiane (në tekstin e mëtejme “EURO”). Dënimi me gjobë nuk mund të tejkalojë njëzet e pesëmijë (25.000) Euro, ndërsa për veprat penale lidhur me terrorizëm, trafikim me njerëz, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk mund të tejkalojë pesëqind mijë (500.000) Euro”.

Si dhe nenin 49 par.1 të KPRK-së, “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, dhe par. 4 “Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale”, ndërkaq në përputhje me paragrafin 5 të këtij nenin të pandehurit i ka shqiptuar dënim me gjobë i cili do të ekzekutohet brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv, ndërkaq për dënimin e shqiptuar me burgim ka përcaktuar dënim të kushtëzuar i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprën të re penale brenda periudhës së verifikimit të përcaktuar si në dispozitiv të aktgjykimit, par.4 i nenit 49 shprehimisht përcakton se: “Kur gjykata shqipton dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim”, andaj gjykata ka shqiptuar dënim me burgim të kushtëzuar ndërkaq ka shqiptuar dënim me gjobë i cili do të ekzekutohet brenda afatit të përcaktuar si në dispozitiv.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 313 par.1 e lidhur me nenin 43, 46, 47, 48, 49 të KPRK-së, të pandehurit i ka shqiptuar dënimet me burgim dhe me gjobë si në piken I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me revokimin e dënimit me kusht nëse i pandehuri kryen veprën tjetër penale brenda periudhës së verifikimit është marrë konform nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon, refuzon apo nuk mund të paguaj dënimin e shqiptuar me gjobë, është marrë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit R.S, me vendbanim në rr. “.....”, në Komunën e Mitrovicës, në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë konform dispozitës së nenit 462 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nënpar.2.1 dhe nën par. 2.6, të KPPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.49/24, me datë 26.12.2024.**

**Zyrtarja ligjore**  
**Blerinda Laiq**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

---

**Blerta KERMENDI**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.